



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 245, dt. 18.12.2015**

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.12.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit për ndërtimin e impiantit të pasurimit të mineralit të kromit, Myç-Mamëz, Kukës me zhvillues subjektin “Burimi Xh” sh.p.k.
  2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e banesës së Man dhe Hate Ferizollit në fshatin Vranisht, sipas projekt-preventivit të hartuar nga specialistët e DRKK-së Shkodër.
  3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**